



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.560, datë 13.11.2020

PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT JOGJYQATAR {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM
SI GJYQATAR NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjet plenare të datave 16.01.2020, 28.09.2020, 19.10.2020 dhe 13.11.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit {...}”, si dhe pasi administroi disa materiale shtesë të vlerësuara nga ai, mbi propozimin përkatës për kualifikimin e kandidatit jogjyqtar {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMITNGA RELATORI

1. Me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, mbështetur në nenin 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 3/c dhe 5, të nenit 48 dhe nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe në pikën 1, të nenit 31, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) vendosi:

I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile

II. Afati i kandidimit

Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. ...”.

2. Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, në procedurën e emërimit për pozicionin e lirë të shpallur përmes vendimit me sipër, ka aplikuar për të marrë pjesë edhe kandidati {...}.

3. Me Vendimin nr.182, datë 02.10.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli vendosi: “1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:1. Për {...} - relator z.Alban Toro. ...”.

4. Më datë 04.10.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përgjashtim relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidati {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 07.10.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion nuk ishte i plotë (mungonte dokumenti që vërteton mosqenien i dënuar me vendim penal të formës së prerë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore), kandidati {...}, në rrugë elektronike, u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. Po më datë 07.10.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, kandidati {...}, depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ndërsa brenda datës 10.10.2019 ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 11-14.10.2019 dhe 24.10.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatin e Gjykatës së Lartë, {...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Më datë 14.10.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij *“të pasjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), me Shkresën nr. 5045/6 prot., u kërkuar informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, {...}.

12. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar informacionin dhe konfirmimin përkatës, ndër të tjerë edhe për kandidatin {...}, me Shkresën nr. 9451/1 prot., datë 21.10.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 5045/20 prot., datë 22.10.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

13. Më datë 11.10.2019 dhe 17.10.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit *“të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit për Statusin, si edhe të kriterit *“të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjën “dh” të nenit 28, të Ligjit për Statusin, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion nga subjektet publikë dhe privatë që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit {...}, subjekte të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

14. Po në kuadër të verifikimit të kushtit dhe kriterit të kandidimit sipas pikës 13 të këtij vendimi, më datë 14.10.2019, u kërkuar informacion në lidhje me punësimin e kandidatit {...}, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë

përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

15. Në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit “*të mostë ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit*”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit për Statusin, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sa i përket kandidatit {...} ka përcjell informacionin e saj më datë 28.10.2019 siç do të përshkruhet më poshtë.

16. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e “*pasjes së zotësisë për të vepruar*”, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka përcjell informacionin e saj më datë 25.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë. Dhe po ashtu, për këtë kriter kandidimi, më datë 25.10.2019, u kërkua informacion edhe nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, e cila ka përcjell informacionin e saj më datë 30.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. SHQYRTIMI NGA KOMISIONI I PROCEDURËS DHE REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

17. Në përfundim të verifikimit, relatori i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, sikurse përcaktohet në pikën 15, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

18. Në Mbledhjen e datës 13.12.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar çmon se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të këtij të fundit, vendosi kalimin çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

III. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I PROCEDURËS DHE REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

19. Procedura dhe rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin {...}, u shqyrtua nga Këshilli në Mbledhjen Plenare të datës 16.01.2020. Në këtë rast, mbas diskutimit të procedurës së ndjekur dhe dokumentacionit të administruar gjatë kësaj procedure, Këshilli vlerësoi se verifikimi nuk ishte i plotë dhe kandidati duhet të plotësonte dokumentacionin e nevojshëm të kandidimit. Konkretisht, Këshilli vendosi që kandidatit {...} t’i kërkohej plotësimi i dokumentacionit si vijon:

- 1) *Konfirmimi nga Dhoma e Avokatisë greke në lidhje me ushtrimin e shërbimit të avokatisë pranë avokatit në Greqi;*

- 2) *Përkthimi i ligjit grek për të kuptuar meqenëse mund të vihet në diskutim interpretimi i qenies së kandidatit asistent avokat dhe a mund të konsiderohet avokat në kuptim të ligjit shqiptar;*
- 3) *Konfirmim nga universiteti grek në lidhje me asistent pedagogun dhe çfarë ka bërë në fakt, a ka qenë lektor i së drejtës në kuptim të ligjit shqiptar;*
- 4) *Konfirmim zyrtar nga universiteti në Zvicër në lidhje me veprimtarinë si kërkues shkencor të kandidatit.*

20. Në zbatim të vendimit të Këshillit sipas pikës 19 të këtij vendimi, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, më datë 17.01.2020, njoftoi kandidatin për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me kushtet dhe kriteret e kandidimit, e më konkretisht të paraqiste:

1. *Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për ushtrimin e profesionit të avokatit të {...}, si dhe për kohën e ushtrimit nga ai të këtij profesioni.*
2. *Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për llojin e aktivitetit të kandidatit pranë Zyrës së Avokatit {...}, si dhe për kohën e këtij aktiviteti.*
3. *Konfirmim nga Zyra e Avokatit {...} për aktivitetet konkrete të kryera nga kandidati pranë kësaj zyre, si dhe nëse ato janë kryer ose jo kundrejt pagesës.*
4. *Konfirmim nga Universiteti National Kapodistrian i Athinës për aktivitetin e kandidatit pranë këtij Universiteti, natyrën dhe kohën e tij.*
5. *Konfirmim nga Universiteti i Zyriut/Institutit Rechtsëissenschaftliches për aktivitetin e kandidatit pranë këtij Universiteti, natyrën dhe kohën e tij.*

21. Në njoftimin elektronik të datës 17.01.2020, relatori i kërkoi kandidatit {...} që të kishte në vëmendje faktin që aktet dokumentare, për konfirmimet si më lart nga autoritetet e huaja, duhet të ishin të certifikuara sipas Konventës së Hagës “Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja” të 5 tetorit 1961, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

22. Kandidati {...}, nëpërmjet një “Letër Sqaruese” të datës 10.02.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5045/2 prot., datë 10.02.2020, depozitoi dokumentet e kërkuara nga Këshilli.

23. Vijimi i shqyrtimit nga Këshilli të rezultateve të verifikimit për kandidatin {...}, për një periudhë disa mujore, u bë i pamundur për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19 dhe masave të marra për parandalimin e përhapjes së tij. Në procedurat e verifikimit të kandidatëve në përgjithësi në kuadër të rekrutimit dhe ngritjes në detyrë, verifikimi përmban dhe të dhëna të klasifikuara “sekret shtetëror”, sikurse edhe të dhëna personale të kandidatëve. Nisur nga kjo, në respektim të Ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, rezultatet e verifikimit për kandidatët në përgjithësi nuk mund të shqyrtohen në mbledhjet plenare të zhvilluara nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë, në kushtet kur

një mënyrë e tillë nuk garanton përmbushjen nga Këshilli të detyrimeve për mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave të klasifikuara “sekret shtetëror”, si dhe për mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të kandidatëve, detyrime të cilat përcaktohen në këto ligje, por edhe në nenet 7 dhe 9, të Kodit të Procedurave Administrative. Për këtë shkak, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit të kandidatëve në përgjithësi bëhet në mbledhje plenare që zhvillohen në ambientet/sallën e mbledhjeve të Këshillit dhe pa praninë e të tretëve. Duke ardhur në rastin konkret, fillimisht, më datë 12.03.2020, Këshilli vendosi pezullimin e organizimit dhe zhvillimit të mbledhjeve plenare në ambientet e selisë së tij. Kjo situatë vijoi deri më datë 22.04.2020, kur Këshilli vendosi rifillimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me Rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Pas kësaj date, zhvillimi i mbledhjeve plenare në sallën e Këshillit ka qenë i pamundur në kushtet kur parametrat e saj nuk garantonin respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Në fund të Korrikut 2020, selia e Këshillit u zhvendos në një godinë tjetër, një ambient i të cilit, që plotëson parametrat për respektimin e masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, u përshtat për zhvillimin e mbledhjeve plenare të tij. Pas kësaj, në Shtator 2020, Këshilli filloi zhvillimin e mbledhjeve plenare në sallën e tij.

24. Shqyrtimi i rezultateve të verifikimit për kandidatin {...}, u planifikua të zhvillohej në mbledhjen plenare të datës 28.09.2020. por, përpara kësaj date, pikërisht më 23.09.2020, relatori i çështjes, z.Alban Toro, depozitoi në Këshill një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të cilës hiqte dorë nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, të {...}. Dorëheqja e z.Toro u miratua me Vendimin nr.12, datë 23.09.2020, të Kryetares së Këshillit.

25. Ndodhur në kushtet kur si anëtar zëvendësues i z.Toro në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, sipas Vendimit të Këshillit nr.13, datë 18.01.2019, ishte Kryetarja e Këshillit, znj.Naureda Llagami, ndërsa ajo nuk mund të ishte relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë, referuar pikës 1, të nenit 63, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, u bë e nevojshme caktimi i relatorit të ri për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin {...}. Për këtë arsye, bazuar në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit 75/2019, pas shortit të hedhur, me Vendimin nr. 353, datë 24.09.2020, Këshilli vendosi: “*Caktimin e z. Ilir Toska si relator në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin {...}*”.

26. Më datë 24.09.2020, në rrugë elektronike, kandidati {...} njoftua rregullisht për zëvendësimin e relatorit në procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit të tij për gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

27. Në Mbledhjen Plenare të datës 28.09.2020, Këshilli vendosi shtyrjen e shqyrtimit të rezultateve të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e

Lartë, për kandidatin {...}, ndërsa konsideroi përgatitjen nga relatori i ri të një relacioni shtesë në lidhje me dokumentacionin e administruar rishtazi gjatë procedurës së verifikimit, sikundër po ashtu, pas një denoncimi të bërë public dhe të mbërritur edhe në adresën e tij, Këshilli vendosi të marrë në kuadër të kësaj procedure informacione dhe dokumente nga disa subjekte publike, e më konkretisht:

- 1) *Materialin e administruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të kandidimit të kandidatit si anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;*
- 2) *Informacion në lidhje me kandidatin nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia “Ligj dhe Drejtësi”;*
- 3) *Përkthimin në gjuhën shqipe i dispozitave të Ligjit Grek për Avokatinë, konkretisht nga neni 1 në nenin 23 të tij.*

28. Më datë 28.09.2020, në rrugë elektronike, kandidati {...} u njoftua rregullisht për shtyrjen e mbledhjes plenare të Këshillit, si dhe për arsyet e kësaj shtyrje.

29. Ndërkohë, në zbatim të vendimit të Këshillit sipas pikës 27 të këtij vendimi, relatori i çështjes dërgoi menjëherë kërkesat për informacion dhe dokumentacion në drejtim të subjekteve publike të sipër përmendura, të cilët kanë përcjellë për Këshillin informacionet dhe dokumentacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë), i fundit më datë 08.10.2020.

30. Shqyrtimi i rezultateve të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatin {...}, vijoi në Mbledhjen Plenare të datës 19.10.2020. Në këtë rast, pas diskutimeve mbi rezultatet e verifikimit, bazuar në pikën 11, Seksioni Ç, Kreu 6, të Vendimit 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që kandidati të njoftohej mbi gjetjet e procedurës së verifikimit që lidheshin me një prej kushteve të kandidimit, atij *“të pasjesjo më pak se 15 vjet përvojë si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe për motivet të cilat mund të sillnin ndalimin e kandidimit për të.

31. Më datë 21.10.2020, në rrugë elektronike, kandidati {...} u njoftua rregullisht për gjetjet e procedurës së verifikimit. Konkretisht, në tekstin e njoftimit, është parashtruar:

“... Gjetja e parë në procedurën e verifikimit lidhet me faktin e pasjes nga ana juaj të përvojës profesionale si “asistent avokat” (në Zyrën e Avokatit {...}, Greqi), për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, në rrethanat kur, sipas ligjit grek për profesionin e avokatit (Ligjit nr. 4194, “Kodi i Avokatisë”), “asistent avokatët” regjistrohen në regjistrin e posaçëm të asistentëve të një prej dhomave të avokatisë, ndërkoqë që gjatë verifikimit nuk është depozituar ndonjë dokument që vërteton një fakt të tillë.

Gjetja e dytë në procedurën e verifikimit lidhet me faktin e pasjes nga ana juaj, për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, të një prej përvojave profesionale të kërkuara nga Kushtetuta dhe ligji, pra si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, ndërsa nga ana juaj, përvoja profesionale e kësaj periudhe është evidentuar si “asistent avokat”.

Në jetëshkrimin e depozituar nga juaj në momentin e kandidimit, pra më datë 26.09.2019, sa i përket përvojës profesionale për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, pra 26 muaj, ajo pasqyrohet si “asistent avokat”, në Zyrën e Avokatit {...}, Athinë, Greqi.

Po në rastin e kandidimit, në funksion të vërtetimit të kësaj përvoje profesionale, nga ana juaj është depozituar një letër e Avokatit {...}, që mban datën 07.02.2017, që është në gjuhën angleze, shoqëruar me përkthimin në shqip, ku sipas përmbajtjes së këtij të fundit, ndër të tjera, parashtrohet: “{...} ka punuar me mua pranë zyrës time si Jurist nga 01.10.2003 deri në 30.11.2005, Gjatë kësaj kohe të praktikës së tij ligjore ai ka treguar aftësi shumë të larta. ... Ai është marrë me çështje të së drejtës civile dhe administrative. ...”.

Në Mbledhjen Plenare të datës 16.01.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi kryerjen e verifikimeve shtesë, përfshirë edhe për përvojën e tuaj për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005. Konkretisht, Këshilli ka vendosur t’ju kërkojë plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, ndër të tjera, edhe me:

- 1) Konfirmim nga Dhoma e Avokatisë greke në lidhje me ushtrimin e shërbimit të avokatisë pranë avokatit në Greqi;*
- 2) Përkthimin (në gjuhën shqipe) të ligjit grek të avokatit, për të kuptuar, meqenëse mund të vihet në diskutim interpretimi i qenies së kandidatit “asistent avokat” dhe nëse një përvojë e tillë mund të konsiderohet përvojë si “avokat” në kuptim të ligjit shqiptar.*

Në respektim të vendimit të Këshillit, relatori i mëparshëm i çështjes (z.Toro), në rrugë elektronike, më datë 17.01.2020, ju ka njoftuar për plotësimin e dokumentacionit, ndër të tjera edhe me:

- 1. Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për ushtrimin e profesionit të avokatit të {...}, si dhe për kohën e ushtrimit nga ai të këtij profesioni.*
- 2. Konfirmim nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për llojin e aktivitetit të kandidatit pranë Zyrës së Avokatit {...}, si dhe për kohën e këtij aktiviteti.*
- 3. Konfirmim nga Zyra e Avokatit {...} për aktivitetet konkrete të kryera nga kandidati pranë kësaj zyre, si dhe nëse ato janë kryer ose jo kundrejt pagesës.*

Në përmbushje të kërkesës së Këshillit, sa i përket përvojës profesionale për periudhën Tetor 2003 - Nëntor 2005, më datë 10.02.2020, ju depozituat:

- 1) Dokumentin “Vërtetim” datë 27.01.2020, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë Athinë, në të cilin, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, thuhet se: “... siç rezulton nga regjistrat e Dhomës së Avokatisë Athinë, {...} Menalao është anëtar i Dhomës së Avokatisë Athinë, i*

regjistruar me 2/04/1974 me Nr. Liçense 005477. i sipërcituari ende mbetet i regjistruar në Regjistrat e Dhomës së Avokatisë...”;

2) Dokumentin “Vërtetim” datë 05.02.2020, lëshuar nga Avokati {...}, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, ndër të tjera, thuhet se: “{...} ka qenë i punësuar në Zyrën time të Avokatisë nga 1.10.2003 deri më 30.11.2005 në pozicionin/cilësinë e Legal Officer. Gjatë kësaj periudhe {...}, si i diplomuar prej Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës më 2003, u punësua në Zyrën time dhe ofroi shërbime asistent avokati, duke ndihmuar në trajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor të çështjeve juridike gjithashtu edhe në ofrimin e këshillimeve juridike për persona fizike dhe ligjorë./ Në kontekstin e bashkëpunimit tonë ai bënte kërkime në legjislacione vendimeve gjyqësore dhe përgatiste fashikujt gjyqësor për mbrojtjen e çështjeve nëpër Gjykata. Gjithashtu, hartonte drafte të Padive në Gjykatat Civile dhe ato Administrative, drafte për kontrata civile dhe tregëtare si dhe dokumente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me Shtetin Grek dhe Autoritetet Administrative Greke./ Konkretisht {...} është paraqitur me autorizim nga mua si asistent avokat ose me autorizim nga të përfaqësuarit e Zyrës time në Gjykata e Krimeve të Lehta dhe në Gjykatat e Pajtimin si edhe pranë Autoriteteve Administrative dhe Shërbimeve Publike për të kryer çështjet e Zyrës time të Avokatisë. Jemi bashkëparaqitur në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Dytë për gjyqe të ndryshme, për të cilat ka kontribuar edhe në përpunimin ligjor dhe në dhënien e këshillave për trajtimin e këtyre çështjeve gjyqësore, si anëtar i Zyrës time ...”.

Ndërkohë, po për përvojën tuaj profesionale të periudhës Tetor 2003 - Nëntor 2005, në respektim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 28.09.2020, në kuadër të verifikimit u administrua, nga Kuvendi i Shqipërisë, dokumentacioni i kandidimit tuaj, në vitin 2017, për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ/KLP.

Në dokumentacionin e administruar nga Kuvendi i Shqipërisë, dorëzuar nga ana juaj, gjendet edhe Dokumenti i datës 10.10.2013, në gjuhën angleze, lëshuar nga shtetasi {...}, ndërsa bashkëlidhur atij gjendet dhe përkthimi në gjuhën shqipe, ku sipas këtij të fundit, ndër të tjera në këtë dokument, parashtrohet se: “{...} ka punuar nën mbikëqyrjen time si një asistent avokat nga 2.11.2003-10.08.2005. Gjatë kësaj kohe ai ka treguar aftësi të shkëlqyera si një shkencëtar dhe si një jurist ushtrues në praktikë. ... Ai ka punuar në çështje që kanë lidhje me punët publike të cilat u zhvilluan në Athinë në 2004 siç janë çështjet e pronësisë, shitblerjes së pasurive të paluajtshme dhe çështje që lidhen me mbrojtjen e ambjentit...”.

Së fundi, po për përvojën tuaj profesionale të periudhës Tetor 2003 - Nëntor 2005, në respektim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 28.09.2020, në kuadër të verifikimit u administrua edhe përkthimi në gjuhën shqipe, bërë me kërkesë të Këshillit, nga përkthyesja zyrtare {...}, i ligjit grek për profesionin e avokatit, Ligjit nr. 4194 - “Kodi i Avokatisë”, nenet 1 deri në 23, në të cilat jepen rregullime në lidhje me profesionin e avokatit, ndërsa në Kapitullin II, nenet 10 e vijues rregullohet fitimi i titullit të avokatit, ku gjenden edhe rregulla për asistent avokatin.

Sipas nenit 10 të Kodit Grek të Avokatisë, për të marrë statusin e asistent avokatit, i diplomuari për drejtësi duhet të paraqes kërkesë për regjistrim si i tillë përpara Kryetarit të Dhomës së Avokatisë së zonës në të cilën ai dëshiron të bëj stazhin (1), ndërsa sipas pikës 4 të këtij neni, “Stazhi fillon me regjistrimin e kandidatit në regjistrin e veçantë të asistentëve të dhomës përkatëse të avokatisë. Statusi i asistentit ruhet për aq kohë sa kërkohet për përfundimin e stazhit dhe pjesëmarrjen e tij të suksesshme në provimet kualifikuese dhe deri në emërimin e tij si avokat”.

Ndërkohë, sipas nenit 11 të këtij Kodi, asistent avokati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e statusit të avokatit (1) dhe se pengesat dhe papajtueshmëritë e përcaktuara për avokatin, vlejnë edhe për asistent avokatin (2), i cili i nënshtrohet ligjit disiplinor dhe ndaj tij mund të jepen dënime disiplinore si për avokatin, ndër to edhe ç’regjistrimi nga regjistri i asistentëve ose zgjatja e kohës së stazhit deri në dy vjet (3).

Më tej, në nenin 6 të këtij Kodi, rregullohen kërkesat ligjore dhe pengesat për të qenë avokat. Konkretisht, ndër të tjera, në këtë dispozitë përcaktohet se: “Avokati duhet: 1. Të jetë shtetas grek ose shtetas i një vendi anëtar të Bashkimit Europian ose i një shteti tjetër, i cili është pale në Konventën për Zonën Ekonomike Europiane. Një grek me origjinë, mund të emërohet avokat me lejen e Ministrit të Drejtësisë, lëshuar pas mendimit të dhomës përkatëse të avokatisë. 2) Të jetë mbajtës i diplomës së Departamentit Juridik të Fakultetit të Drejtësisë të një Institucioni të Arsimit të Lartë në Greqi ose një diplome ekuivalente dhe përkatës nga një shtet tjetër, me kusht që të jetë njohur ne përputhje me procedurat ligjore. 3. Të mos jetë dënuar në mënyrë të parevokueshme: ... 4. Të mos jetë privuar në mënyrë të pakthyeshme nga të drejtat civile. ... 5. Të mos jetë vendosur në mbrojtje gjyqësore të plotë ose të pjesshme, ... 6. Të mos ketë statusin e klerikut apo të murgut”.

Ndërsa, në nenin 13 të këtij Kodi, rregullohet “Kohëzgjatja e stazhit-Përmbajtja”, ku në pikën 1 të tij përcaktohet se: “1. Stazhi zgjat tetëmbëdhjetë (18) muaj”.

Së fundi, në nenin 12 të këtij Kodi, rregullohen “Të drejtat e paraqitjes të asistent avokatit”, duke u përcaktuar se: “1. Asistent avokati mund të paraqitet në gjykatat penale, autoritetet e procedurës paraprake, gjykatat e paqit në shqyrtimin e kundërvajtjeve penale, në marrjen e deklarimeve me betim, si dhe para çdo autoriteti administrative. 2. Asistent avokati mund të paraqitet sëbashku me avokatin tek i cili bën stazhin dhe të nënshkruajë parashtrime, shënime dhe memorandum, në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë”.

Referuar sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të të drejtës për t’u dëgjuar të subjektit në një procedure administrative, si dhe në zbatim të pikës 11, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, vendosi që ju të **ftoheni të paraqesni shpjegime lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si dhe çdo dokumentacion mbështetës sipas vlerësimit tuaj.**

Afati për paraqitjen e shpjegimeve dhe dokumenteve mbështetës është 5 ditë. Ky afat fillon nga dita e nesërme e marrjes së këtij njoftimi.

Shpjegimet mund t'i paraqisni me shkrim, drejtpërdrejt pranë Zyrës së Prokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose në rrugë elektronike, ndërsa dokumentet mbështetës, në origjinal ose të njësuar me origjinalin, duhet t'i paraqisni pranë Zyrës së Protokolit të Këshillit.

Bashkëlidhur gjeni kopje të përkthimit në gjuhën shqipe, bërë me kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga përkthyesja zyrtare {...}, të Kodit Grek të Avokatisë (Ligjit nr. 4194), nenet 1 deri në 23”.

31. Më datë 22.10.2020, në rrugë elektronike, kandidati {...}, pasi konfirmon marrjen e njoftimit të Këshillit, i kërkon atij shtyrjen e afatit për paraqitjen e shpjegimeve, duke parashtruar dhe arsyet mbi të cilat bazonte këtë kërkesë. Kërkesa është shqyrtuar menjëherë nga Këshilli, i cili, me Vendimin e datës 22.10.2020, protokolluar me aktin {...}, vendosi: “1. Pranimin e kërkesës së kandidatit {...}. 2. Shtyrjen afatit të paraqitjes së shpjegimeve dhe të dokumenteve mbështetës në lidhje me gjetjet e procedurës së verifikimit, deri më datë 04.11.2020”.

32. Më datë 04.11.2020, kandidati depozitoi shpjegimet e tij në Këshill, protokolluar me aktin {...}. Në shpjegimet e tij kandidati parashtroi:

“... Fillimisht do ju parashtroj disa vendimmarrje të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të cilat kanë vendosur disa standarte kushtetuese për nocionet juridike Jurist i Nivelit të Lartë dhe Jurist i Spikatur.

I.Standardet e vendosura nga vendimmarrjet e institucioneve kushtetuese. Raste të ngjashme të interpretimit të nocionit Jurist i nivelit të lartë/Jurist i spikatur nga KED.

Përsa i përket interpretimit të togfjalëshit “Jurist i nivelit të lartë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i cili është një organ i ri kushtetues, që u krijua me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndodhura me miratimin në vitin 2016 të paketës legislative të reformës në drejtësi, ka krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar nëpërmjet vendimmarrjes së tij në interpretimin e nocioneve juridike: Jurist i nivelit të lartë/ Jurist i spikatur. Konkretisht, në tri vendimmarrjet e tij në garën e kandidimit për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese¹, pozicione në të cilat parashikohen të njëjtat kritere kushtetuese sikurse për kandidatët në Gjykatën e Lartë, ky organ ka argumentuar që eksperiencat e punësimit të këtyre kandidatëve duhet të llogariten si eksperiencat e një Juristi të një niveli të lartë. Në rast se analizojmë karrierën profesionale të kandidatës F.P. , ajo në kohën e kandidimit për në Gjykatën Kushtetuese, kishte ushtruar këtë veprimtari profesionale:

1. Praktikante Avokate pranë Dhomës së Avokatisë në Bari, Itali në periudhën dhjetor 2000-janar 2004;

¹ Vendim nr.62, datë 24.7.2019, F.P.; vendim nr.102, datë 30.7.2018, E.T. dhe vendimi nr. 34, datë 9.10.2020, S. B.; vendim nr. 141, datë 2.12.2019.

2. *Avokate pranë Dhomës së Avokatisë në Bari, Itali, për periudhën janar 2004-dhjetor 2008;*
3. *Pedagoge efektive pranë Departamentit të Shkencave Juridike, në Albanian University. Lënda: Regjimi juridik i tokës; si dhe Grupet jofitimprurëse të interesit. Bachelor, për periudhën nëntor 2007-mars 2009.*
4. *Specialiste e nivelit të lartë pranë Drejtorisë së kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese, për periudhën mars 2009-maj 2011;*
5. *Këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, për periudhën 18.5.2011 dhe, aktualisht;*
6. *Lektore e jashtme e së Drejtës Publike pranë Universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë”(nëntor 2007-aktualisht), lektore për Regjimin Juridik të Tokës, si dhe për grupet jofitimprurëse të interesit pranë Albanian University (mars 2009-dhjetor 2010), Lektore për Teknikën Legjislative pranë Universitetit Europian të Tiranës (mars 2018-qershor 2018).*

Bazuar në eksperiencat e mësipërme, KED konstatoi se kandidatja F.P. ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kush (Jurist i nivelit të lartë) për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 dhe shkronja “a” e pikës 2, të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000. Gjithashtu, sa i përket veprimtarive profesionale të kandidatës tjetër, E. T.:

1. *Ndihmëskomisionere pranë Avokatit të Popullit, periudha shtator 2000-shkurt 2006;*
2. *Avokate pranë “Boga & Associates & KPMG”, periudha korrik 2006-mars 2007;*
3. *Këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, periudha prill 2007-aktualisht;*
4. *Lektore e jashtme dhe eksperte në Shkollën e Magjistraturës, Shkollën e Administratës Publike, Shkollën e Avokatisë, Fakultetet e Drejtësisë, Ekonomik dhe i Shkencave Sociale në universitetet publike, Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar të Tiranës, Universitetin “Polis”, Universitetin “Justicia”, Universitetin “Ilyria” dhe Universitetin “Luarasi”.*

Bazuar në eksperiencat e mësipërme të kandidatës E. T., KED ka konstatuar se E. T. ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht (Jurist i nivelit të lartë) për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 dhe shkronja “a” e pikës 2, të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000.

Në rastin e kandidatës S. B. KED, nisur nga natyra e profesionit që ushtronte kandidate (Notere), interpretoi që lloji i detyrave që noteri kryen, zbatimi i veprimtarisë në të mirë dhe në funksion të publikut, pra në tërësi veprimtaria profesionale e noterit duhet të përfshihet në kategorinë e një veprimtarie të spikatur në fushën e së drejtës². Prandaj, KED vlerësoi se kandidatja S. B., duke qenë se ka një përvojë të kombinuar si në profesionin e avokatisë³, ashtu edhe në atë të noterisë⁴, me përvojën e saj profesionale ka plotësuar parashikimet e pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 7/a të ligjit nr.

² S.B, vendim nr.141, datë 2.12.2019, f.9-10.

³ Avokate pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë, për periudhën prill 2001-janar 2011.

⁴ Notere pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, për periudhën prill 2011-aktualisht.

8577/2000. Kështu që, KED erdhi në përfundimin se kandidatja përmbushte kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2, të nenit 7/a, të ligjit nr.8577/2000.

Gjithashtu, në garën e kandidimit për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të cilin parashikohen të njëjtat kritere kushtetuese sikurse për kandidatët në Gjykatën e Lartë, nga ana e Kushtetutës shqiptare: **15 vite pune si Jurist të spikatur bazuar në nenin 147, pika 3 e Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1, të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016**, KED ka kualifikuar dy kandidatura duke i renditur ato në nivelin e Juristëve të spikatur⁵. Rezulton se në kohën e kandidimit, kandidatja L. T. kishte ushtruar veprimtari profesionale si: Specialiste Gjyqësori në Drejtorinë Juridike, në periudhën 25.2.1997 e në vazhdim, pranë Bashkisë Tiranë. Ky organ bazuar në këtë eksperiencë punësimi ka konstatuar që kandidatja L. T. kishte ushtruar së paku për 15 vjet, veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga **pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1, të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016**.

Pozicioni i punës si specialiste e Gjyqësorit, i mbajtur nga kandidatja për një kohë të konsiderueshme, për rreth 22 vjet në Bashkinë më të madhe në vend, është interpretuar nga KED si eksperiencë e cila futet në kategorinë e përcaktuar nga Kushtetuta dhe ligji. Duke mbajtur në konsideratë këtë rrethanë specifike të karrierës së kandidates dhe kushtin si Jurist që kërkon neni 199/1/c i ligjit nr. 115/2016, KED ka vlerësuar se kandidatja plotësonte kushtin ligjor të Juristit të spikatur dhe kushtetues lidhur me pozicionin e punës, që ajo ka mbajtur për më shumë se 15 vjet (afro 22 vjet në këtë pozicion)⁶.

Ndërkohë, përse i përket një tjetër vendimit të KED-së, për një kandidaturë në pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, KED ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidates J. A. S⁷. Kandidatja kishte ushtruar këto veprimtari profesionale në kohën e kandidimit:

1. Asistentpedagoge, për periudhën janar 2004-shtator 2005, pranë Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë;
2. Pedagoge, për periudhën shtator 2005-25 mars 2006, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë;
3. Specialiste pranë Këshilltarit Ligjor, për periudhën 27 mars 2006-7 nëntor 2007, pranë Presidentit të Republikës;
4. Specialiste për Marrëdhëniet me Gjyqësorin, për periudhën 7 nëntor 2007-30 janar 2013, pranë Presidentit të republikës;
5. Specialiste për Marrëdhëniet me Gjyqësorin, për periudhën 30 janar 2013-31 janar2014, pranë Presidentit të republikës, listë pritjeje;
6. Jurist për periudhën 1 shkurt 2014 deri 30 shtator 2015, pranë projektit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, projekti “Shërbime Sociale Inovative”;
7. Specialiste për periudhën 19 shkurt 2016-16 shkurt 2017, pranë Bashkisë Tiranë;

⁵ Vendim nr. 141, datë 2.12.2019, J.A. S., vendim nr. 140, datë 2.12.2019, L.T.

⁶ Shiko f.11 të vendimit nr. 140, datë 2.12.2019 të KED-së.

⁷ Shiko f.11 të vendimit nr. 141, datë 2.12.2019 të KED-së.

8. *Specialiste Drejtoria Juridike, për periudhën 16 shkurt 2017-30 nëntor 2017, pranë Bashkisë Tiranë;*
9. *Këshilltare Ligjore, për periudhën 1 dhjetor 2017-aktualisht, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;*
10. *Lektore me kohë të pjesshme në Departamentin e Shkencave Juridike, Fakulteti I Shkencave Shoqërore, Albanian University, Tiranë, për vitet akademike 2009-2015;*
11. *Asistepedagoge e jashtme në Universitetin “Luarasi”për periudhën tetor 2015 deri në mars 2016;*
12. *Asistentpedagoge në Universitetin e Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë, për vitin akademik 2017-2018.*

Bazuar në gjetjet e tij, KED konstatoi se kandidatja J. A. S. kishte ushtruar për sa paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 3 e nenit 147/d të Kushtetutës dhe shkronja “c”e pikës 1, të nenit 199, të ligjit nr. 115/2016. Pozicioni i punës së Këshilltares ligjore, e mbajtur nga kandidatja në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, pedagoges dhe lektore për një periudhë të konsiderueshme nga viti 2004 e në vazhdim, me vetëm disa vite ndërprerje, Specialistes së Marrëdhënies me Gjyqësorin në Institucionin e Presidentit e përfshinte kandidaten në kategorinë e juristëve të spikatur. Duke mbajtur në konsideratë këto pozicione specifike të karrierës së kandidates dhe kushtin si jurist që kërkon neni 199/1/c i ligjit nr. 115/2016, KED vlerësoi se kandidatja e plotësonte kushtin ligjor dhe kushtetues lidhur me pozicionin e punës që ajo ka mbajtur për më shumë se 15 vjet.

Nga vendimet e mësipërme vihet re qartazi që KED ka vendosur standarde të qarta ligjore në interpretimin e toggjalëshit: Jurist i nivelit të lartë/ Jurist i spikatur. Ky organ ka kryer një kualifikim ligjor të kandidatëve për pozicionet e shpallura në Gjykatën Kushtetuese dhe ILD, duke krijuar tashmë një praktikë juridike të qartë se cilat janë kriteret e të qenit Jurist i spikatur/ Jurist i nivelit të lartë. Mendoj që karriera ime profesionale dhe niveli i lartë akademik që unë kam arritur përbëjnë element të cilat më kategorizojnë në kategorinë e “Jurist i nivelit të lartë në Administratën Publike ose në fusha të së Drejtës⁸”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

II. Shpjegime mbi gjetjen nr. 2, gjatë procedurës së verifikimit të kualifikimit ligjor për kandidaturën time në Gjykatën e Lartë

Gjetja e dytë në procedurën e verifikimit lidhet me faktin e pasjes nga ana ime, për periudhën tetor 2003-nëntor 2005, të një prej përvojave profesionale të kërkuara nga Kushtetuta dhe ligji, pra si avokat, profesor ose lektor i së Drejtës, Jurist i nivelit të Lartë në Administratën Publike ose në fusha të tjera të së Drejtës, ndërsa nga ana juaj, përvoja profesionale e kësaj periudhe është evidentuar si “asistent avokat”.

1. Shpjegime për gjetjen nr. 2

⁸ Gjithmonë referuar eksperiencës time të punësimit pranë zyrës së avokatit {...}.

Në lidhje me këtë gjetje, duke parë situatën juridike dhe faktike, organi juaj i nderuar duhet të interpretojë në rast se pozicioni im ligjor në këtë zyrë si Jurist plotëson një nga tri cilësitë që kërkon neni 136, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 49, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Së pari, duhet cituar që KLGJ-ja është organi i cili vendos nëse një veprimtari profesionale duhet të përfshihet ose jo në këtë paragraf. Qëllimi primar i këtij paragrafi të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 është përzgjedhja në këtë gjykatë e individëve të cilët kanë arritur një nivel të lartë juridik, duke spikatur në një ose disa fusha të së Drejtës, me qëllimin që emërimi i tyre t’i shërbejë cilësisë së vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, që nëpërmjet ardhjes së këtyre gjyqtarëve nga fusha të ndryshme të së Drejtës, garantohet edhe një përbërje e Gjykatës së Lartë me individë me vlera të posaçme profesionale.

Nga dy dokumentet zyrtare që ju dispononi në dosjen time të kandidimit, që provojnë periudhën e punësimit tim pranë zyrës së avokatit {...}, tregohet qartë që unë kam qenë i punësuar në këtë zyrë avokatie si Legal Officer dhe kam ofruar për njëzet e gjashtë (26) muaj shërbimet e Legal Officer dhe të asistentit të avokatit. Duke lexuar me vëmendje shërbimet e kryera⁹ të asistentit të avokatit në zyrën e avokatit, {...}, gjatë periudhës së punësimit tim, mendoj që një asistent i avokatit në Athinë është në nivelin e avokatit shqiptar bazuar në tagret dhe të drejtat që ai ka në ushtrimin e këtij profesioni.

Gjithashtu, ka një vendimarrje nga ana e KED-së¹⁰ në një rast të ngjashëm, ku eksperiencia e kandidates si praktikante/ asistente avokate për katër vite në Dhomës Kombëtare të Avokatisë në Bari-Itali u pranua nga ky organ si eksperiencë e vlefshme për të plotësuar kriterin e të qenët Jurist i nivelit të lartë. Kjo eksperiencë e kandidates u gjykua nga KED-ja që është tërësisht e barasvlefshme me detyrat/shërbimet e Juristit të nivelit të lartë, duke plotësuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 125, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili është i ngjashëm në përmbajtje dhe thelb me nenin 136 par. 3 i Kushtetutës.

2. Plotësimi i kriterit kushtetues dhe ligjor: Jurist i nivelit të lartë, nga ana e kandidaturës sime¹¹

Sikurse u parashtrua më sipër, pozicioni im ligjor në këtë zyrë ishte ai i Legal Officer/Juristit. Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të punësimit tim në këtë zyrë avokatie kam bindjen që kualifikimet e mia akademike dhe profesionale plotësojnë kriterin e Juristit të lartë në një ose disa fusha të tjera të së Drejtës¹². Mendoj që kandidatura ime e përmbush

⁹ Të pasqyruara në f.5 të këtyre shpjegimeve.

¹⁰ Vendim nr. 62, datë 24.7.2019, F.,P., f.10.

¹¹ Sikurse përcakton neni 136, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 49, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹² Neni 136, paragrafi 3 i Kushtetutës së RSH-së. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së Drejtës, juristë të nivelit të lartë në Administratën Publike ose në fusha të tjera të së Drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur duhet të kenë gradë shkencore në Drejtësi.

këtë kriter kushtetues dhe ligjor¹³, pasi eksperiencia ime e punës në një zyrë avokatie të një shteti dhe kryeqyteti evropian, siç është Athina, vazhdimësia ime e karrierës, e cila ka pasur gjithmonë zhvillime progressive, përlligjin kandidaturën time si Jurist të një niveli të lartë, përcaktuar nga neni 136, prg. 3 i Kushtetutës dhe neni 49, pika 1 e ligjit 49/2016¹⁴.

Kandidimi im në këtë garë si Jurist i nivelit të lartë mbështetet gjithashtu në formimin tim akademik, i cili është përfunduar deri në nivelin e doktoraturës në një shtet të BE-së (me vlerësimin maksimal, shkëlqyeshëm). Gjithashtu, në bursat e ekxelencës të fituara nga unë, në shtetin grek dhe zviceran, të cilat tregojnë qartazi nivelin e lartë të vlerësimit që institucionet akademike të këtyre shteteve europiane kanë dhënë për aftësitë e mia profesionale¹⁵. Nga ana juaj, si organ, duhet të mbahet parasysh fakti shumë domethënës që një student shqiptar arrin të diplomohet (dhe më pas të punësohet) në të gjitha nivelet studimore në shtetin grek, ku të qenët shqiptar, sidomos në ato vite, ishte një vështirësi më vete. Gjithashtu, Fakulteti Juridik i Athinës konsiderohet botërisht si një ndër fakultet më të mirë në botë dhe renditja e tij në rang botëror në vendin e 300-të, është një tjetër argument që përlligj kandidaturën time si Jurist i nivelit të lartë. Studentët e këtij Fakulteti kanë qenë fitues shumë herë të Moot Courts në nivele botërore, çka tregon peshën dhe spikatjen e veçantë të Juristëve të diplomuar nga ky Universitet në rang botëror. Krahas këtyre arritjeve shumë të larta akademike, figura ime është e plotësuar dhe në anën gjuhësore, pasi studimet e mia në të gjitha nivelet janë kryer në gjuhë të huaja dhe unë flas zyrtarisht katër gjuhë të BE-së¹⁶ (anglisht, gjermanisht, italisht dhe greqisht). Njohja në detaje e legjislacionit grek dhe atij zviceran përbëjnë, gjithashtu, cilësi të veçanta të miat, të cilat duhet të vlerësohen nga ana e organit tuaj.

Duhet cituar, po ashtu, se zyra e avokatit, z. Aristeidis Trigonis funksionon që në vitin 1974 e licensuar¹⁷, me një emër shumë të madh në kryeqytetin e një shteti evropian. Punësimi I një juristi shqiptar në një zyrë të këtij niveli, në një shtet të huaj, përbën një spikatje të kandidatit, duke marrë parasysh kohën dhe vendin ku ky kandidat ka kryer këtë arritje. Punësimi im i mëvonshëm si asistent Profesor pranë Universitetit Kombëtar të Athinës është një arritje e madhe akademike dhe profesionale e një juristi, e cila tregon nivelin e lartë të vlerësimit që ky Universitet më ka bërë. Gjithashtu, pas kthimit tim në Shqipëri, në vitin 2009, unë u punësova si Profesor pranë Universitetit Evropian të Tiranës. Vlerësimet e

¹³ Jurist i nivelit të lartë në një fushë ose disa fusha të së Drejtës.

¹⁴ i. Jurist/Asistent avokat pranë zyrës së {...}; ii. Asistent Profesor pranë {...} në Universitetin Kombëtar të Athinës; iii. Profesor pranë Universitetit Evropian të Tiranës; iv. Kërkuar Shkencor pranë Universitetit të Zyrihut me bursën e ekxelencës së shtetit zviceran; v. Dekan pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti "Luarasi"; vi. Profesor dhe Shef Departamenti pranë Universitetit Neë York, në Tiranë; vii. Komisionet Publik me statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë.

¹⁵ 1. Bursë nga Ministria e jashtme greke nga viti 2004-2009 (Vërtetimin që gjendet në formën e kërkuar nga ligji në dosjen time të kandidimit). 2. Bursë nga Fondacioni prestigjioz "Onassis" (Vërtetim që gjendet në formën e kërkuar nga ligji dhe që gjendet në dosjen time të kandidimit). 3. Bursë e ekxelencës e akorduar nga shteti zviceran (Vërtetim që gjendet në formën e kërkuar nga ligji dhe që gjendet në dosjen time të kandidimit).

¹⁶ Zotëroj në formë.

¹⁷ Ju dispononi dokumentin zyrtar me vulën apostile të licensës së tij dhe regjistrimin zyrtar si avokat të tij që në vitin 1974, në Dhomën Kombëtare të Avokatisë në Athinë.

punës sime nga ana e ish-studentëve të mi i keni në dosjen time të kandidimit. Atje shikohet qartë se unë jam vlerësuar nga ata si një ndër Profesorët më të mire të Fakultetit të Drejtësisë të UET-së. Kërkimi im shkencor në Universitetin e Zyrihut dhe akordimi i bursës së ekselencës janë prova, të cilat tregojnë qartë aprovimin e kandidaturës sime në nivele shumë të larta akademike nga një Universitet, i cili renditet në njëqind (54/100) universitetet më të mira të botës. Kthimi im në Shqipëri pas kësaj eksperince u shoqërua me pozicionin e Dekanit pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Luarasi”, ku dhe atje vlerësimet e studentëve për figurën time kanë qenë maksimale (këto vlerësime gjenden në dosjen time). Punësimi im pranë Neë York University në pozicionin e Shefit të Departamentit të Drejtësisë përbën një arritje të madhe akademike, duke marrë në konsideratë faktin shumë domethënës që ky Universitet mësimdhënien e zhvillon tërësisht në gjuhën angleze. Edhe në këtë Universitet vlerësimet e studentëve për figurën time kanë qenë maksimale (këto vlerësime gjenden në dosjen time). Në fund do të doja të ndalesha te punësimi im si Komisionet Publik pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, i cili përbën përbën një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Pozicioni i Komisionerit mbahet nga ana ime që nga data 30.3.2018. Statusi që unë gëzoj nga ky pozicion është ai i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Besoj që punën time e kam kryer me një devotshmëri të lartë dhe kjo vihet re nga cilësia e ankimeve të mia, ku të gjitha janë pranuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Niveli im profesional në këtë detyrë është rritur shumë, pasi seancat gjyqësore që zhvillohen pranë KPA-së më kanë ofruar njohjen nga afër të praktikës gjyqësore në sfera të ndryshme të së Drejtës.

Bazuar në këto arritje të mia profesionale/akademike dhe në praktikën e krijuar nga një organ tjetër kushtetues (e cila u pasqyrua në detaje, më sipër, nga ana ime), i cili, nëpërmjet vendimmarrjes së tij, ka vendosur standardet kushtetuese për kualifikimin ligjor të kandidaturave në pozicione të cilat kanë si kritere kushtetuese të njëjtat kritere sikurse anëtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, mendoj që kandidatura ime plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. Gjetja e parë¹⁸

Gjetja e parë në procedurën e verifikimit lidhet me faktin e pasjes nga ana ime të përvojës profesionale si “asistent avokat” (në zyrën e avokatit {...}, Athinë, Greqi) për periudhën tetor 2003-nëntor 2005, në rrethanat, kur, sipas ligjit grek për profesionin e avokatit (ligjit nr. 4194 , “Kodi i Avokatisë”), “asistent avokatët” regjistrohen në regjistrin e posaçëm të asistentëve të një prej Dhomave të Avokatisë, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk është depozituar ndonjë dokument që vërteton një fakt të tillë.

¹⁸ Gjetjet gjatë procedurës së verifikimit të një prej kushteve të kandidimit në Gjykatën e Lartë “të pasjes jo më pak se 15 vjet përvojë si avokat, profesor ose lektor i së Drejtës, jurist i nivelit të lartë në Administratën Publike ose në fusha të tjera të së Drejtës”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Përgjigje të paqartësisë/gjetjes suaj për plotësimin e 15 viteve pune si Jurist i nivelit të lartë

Në dokumentet zyrtare të dorëzuara nga ana ime që i përkasin eksperiencës sime si Legal officer/ Jurist (Shërbime të ofruara si asistent avokat) pranë zyrës së avokatit Aristeidis Trigonis, unë kam paraqitur pranë jush dy vërtetime, të cilat ju i përmendni në dokumentin tuaj, të nisur në postën time elektronike, në datën 12.10.2020. Këto dy dokumente janë përkatësisht:

1. Dokumenti i dorëzuar nga unë pranë jush brenda afatit të datës së kandidimit, që mban datën 7.2.2017, që është në gjuhën angleze dhe është i bashkëshoqëruar me një përkthim në gjuhën shqipe. Në këtë vërtetim, {...} citon që: “ {...} ka punuar me mua pranë zyrës sime si Jurist nga 1.10.2003 deri në 30.11.2005. Gjatë kësaj kohe të praktikës së tij ligjore, ai ka treguar aftësi shumë të larta...Ai është marrë me çështje të së drejtës civile dhe administrative...”, dhe
2. Dokumenti i dorëzuar pranë jush në datën 10.2.2020 (tashmë me vulat përkatëse të kërkuara nga ana juaj) që mban datën 5.2.2020, lëshuar nga avokati {...} drejtuar KLGJ-së, në të cilin, sipas përkthimit në gjuhën shqipe, ndër të tjera, thuhet se: “{...} aka qenë i punësuar në Zyrën time të Avokatisë nfa 1.10.2003 deri më 30.11.2005 në pozicionin/cilësinë e Legal Officer. Gjatë kësaj periudhe, {...}, si i diplomuar prej Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Kombëtar dhe Kapodistrian i Athinës më 2003, u punësua në Zyrën time dhe ofroi shërbime asistent avokati, duke ndihmuar në trajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor të çështjeve juridike, gjithashtu, edhe në ofrimin e këshillimeve juridike për persona fizikë dhe ligjorë. / Në kontekstin e bashkëpunimit tonë, ai bënte kërkime në legjislacione të vendimeve gjyqësore dhe përgatiste fashikujt gjyqësor për mbrojtjen e çështjeve nëpër gjykata. Gjithashtu hartonte drafte të padive në Gjykatat Civile dhe ato Administrative, drafte për kontrata civile dhe tregtare, si dhe dokumente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me shtetin grek dhe autoritetet administrative greke. / Konkretisht {...} është paraqitur me autorizim nga unë si asistent avokat ose me autorizim nga të përfaqësuarit e Zyrës time në Gjykatat e Krimeve të Lehta dhe në Gjykatat e Pajtimit, si edhe pranë Autoriteteve Administrative dhe Shërbimeve Publike, për të kryer çështjet e Zyrës sime të Avokatisë. Jemi bashkëparaqitur në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Dytë për gjyqe të ndryshme, për të cilat ka kontribuar edhe në përpunimin ligjor dhe në dhënien e këshillave për trajtimin e këtyre çështjeve gjyqësore, si anëtar i Zyrës sime...”.

Në të dyja dokumentet zyrtare, që gjenden në dosjen time të kandidimit, parashtrohet qartë dhe në mënyrë eksplicite nga titullari i Zyrës së Avokatisë se pozicioni i mbajtur nga ana ime në zyrën ligjore të avokat {...} ka qenë ai i “Legal Officer” (Jurist) dhe që, njëkohësisht, Brenda këtij pozicioni, unë kam ofruar pranë zyrës së tij shërbimet e një asistenti të avokatit. Më poshtë po ju paraqes, në mënyrë analitike, por jo shteruese, shërbimet e mia në pozicionin e juristit dhe të asistentit të avokatit që unë ofroja në këtë zyrë.

1. Shërbimet profesionale si Jurist pranë zyrës së avokatit, {...}

- a. Ndhëmë në trajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor të çështjeve juridike;
- b. Ofrim këshillimesh juridike për persona fizikë dhe ligjorë;
- c. Kryerje kërkimesh në legjislacione të vendeve të ndryshme të BE-së të vendimeve gjyqësore dhe përgatitja e fashikujve gjyqësor për mbrojtjen e çështjeve nëpër gjykata;
- d. Hartim draftesh të padive në Gjykatat Civile dhe ato Administrative, draftë për kontrata civile dhe tregtare, si dhe dokumente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me shtetin grek dhe autoritetet administrative greke;
- e. Hartimi i legjislacioneve ndërkombëtare në nivel krahasues;
- f. Pjesëmarrje në takime ndërkombëtare dhe kombëtare;
- g. Përgatitje e amicus curiae në raste specifike, të cilat lidheshin drejtpërdrejtë me legjislacionin shqiptar dhe atë grek;
- h. Asistim në zhvillimin dhe implementimin e projekteve juridike që kishte kjo zyrë me ente të ndryshme publike dhe private.

2. Shërbimet profesionale si asistent pranë zyrës së avokatit {...}

- a. Përfaqësim me autorizim nga avokati si asistent avokat ose me autorizim nga të përfaqësuarit e Zyrës së tij në Gjykatat e Krimeve të lehta dhe në Gjykatat e Pajtimit, si edhe pranë Autoriteteve Administrative dhe Shërbimeve Publike, për të kryer çështjet e Zyrës të Avokatisë¹⁹.
- b. Bashkëpërfaqësim me avokatin, {...}, në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Dytë, për gjyqe të ndryshme, për të cilat kam kontribuar edhe në përpunimin ligjor dhe dhënien e këshillave për trajtimin e këtyre çështjeve gjyqësore, si anëtar i zyrës së tij. Pra, praktikisht, ushtrija shërbimet e asistentit të avokatit, të parashikuara në nenin 12 të Kodit të Avokatisë, sikurse e citon dhe avokati, {...}, në dokumentet zyrtare dorëzuar pranë organit tuaj²⁰.

Bazuar në nenin 253 të Kodit të Procedurave Civile të dyja aktet e depozituara pranë jush nga ana e avokatit janë akte zyrtare, që janë përpiluar nga një avokat, brenda kufijve të kompetencës së tij, ka lëshuar ndaj institucionit tuaj. Bazuar në këtë nen, këto dy akte përbëjnë prova të plota të punësimit tim ligjor në këtë zyrë avokati në pozicionin e Legal Officer.

Përsa i përket mosregjistrimit tim zyrtar si avokat (por që nuk ka lidhje me plotësimin e kriterit të punësimit, pasi unë kam qenë i punësuar në cilësinë e Legal Officer dhe ofroja shërbimet si asistent i avokatit), ju lutem, referohuni nenit 6, pikës “a” të Kodit të Avokatisë greke, që lidhet me mosposedimin nga ana ime të nënshtetësinë greke²¹. Nga ana e organit

¹⁹ Shiko nenin 12, paragrafi i parë i Kodit të Avokatisë në Greqi.

²⁰ Shiko nenin 12, paragrafi i dytë I Kodit të Avokatisë në Greqi.

²¹ Bazuar në nenin 6 të Kodit të Avokatëve në Greqi, i cili në paragrafet e tij sqaron në detaje kushtet ligjore që duhet të zotërojë një avokat për t’u regjistruar pranë një Dhome Kombëtare Avokatie në Greqi, unë, duke mos plotësuar kushtin në paragrafin e parë të këtij neni, pra pasjen e nënshtetësisë greke/europiane ose të qenët homogjen, nuk mundesha të regjistrohesha formalisht. Ky nen, sikurse mund të vini re, është diskriminues, pasi është antikushtetues dhe shkel të drejtën e punës së individëve të huaj në shtetin Helen. Unë plotësoja të gjitha

tuaj duhet të merret e mirëqenë eksperiencia ime e punësimit si Jurist së bashku me shërbimet e ofruara nga ana ime pranë kësaj zyre avokati si asistent i avokatit {...}.

IV. Historiku i kandidimit tim që nga data e dorëzimit të dokumentacionit ligjor pranë KLGJ-së

Procesi i përzgjedhjes së kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë ka nisur që në datën 11.9.2019. Në datën 16.1.2020, ju keni zhvilluar mbledhjen e parë për kandidaturën time, mbledhje e cila u shoqërua me publikime në mediat publike të të dhënave që gjendeshin në dosjen time. Në këto publike përmendeshin të dhëna abusive rreth studimeve të mia jashtë Shqipërisë, duke hedhur aludime që këto të dhëna /studime janë të falsifikuara²². Në këtë mbledhje më është kërkuar nga ana juaj të plotësoj disa dokumente dhe, në datën 10.2.2020, unë kam dorëzuar pranë jush dokumentacionin kërkuar në formën e kërkuara nga ligji²³ (Vulat shoqëruese të institucioneve përkatëse bashkëshoqëruar me vulën apostile). Krahas dokumenteve të kërkuara kam depozituar pranë institucionit tuaj dokumente shtesë për të ndihmuar organin tuaj në vërtetësinë e deklaratave të mia dhe dokumenteve që unë depozitova pranë jush²⁴. Në mbledhjen e datës 28.9.2020, përsëri në media u publikuan

kushtet ligjore të parashikuara në nenin 6 (përveç pikës “a”) . Duhet të mbahet parasysh nga ana juaj fakti që praktika greke lejon punësimin e individëve që kanë përfunduar studimet për Drejtësi në një zyrë avokatie (rasti im) dhe të ofrojë shërbimet e një asistent avokati (me autorizim, gjithmonë të zyrës, kryhej paraqitja si asistent avokat në gjykatat që parashikohen nga neni 12 i Kodit të Avokatisë greke). Gjithashtu, ky punësim i lejohej (në praktikën greke merret i mirëqenë ky fakt juridik) edhe studentëve të cilët ishin në fund të studimeve të tyre dhe kishin pak provime për të dhënë. Gjykimi juaj si organ duhet të marrë parasysh faktin se nga ana ime nuk mund të bëhej më shumë në aspektin e regjistrimit, duke ditur që Greqia në këtë dispozitë diskriminonte dhe shkelte hapur të drejtat kushtetuese të individëve të huaj, të cilët kishin përfunduar studimet në këtë shtet.

²² Ndërkohë që KLGJ-ja disponon këto diploma në formë zyrtare dhe, me korrespondencën që ka pasur me Ministrinë e Arsimit, ka verifikuar vërtetësinë e plotë të tyre.

²³ i) Kohëzgjatja e përvojës sime profesionale në lidhje me ushtrimin e profesioneve të mia që nga koha e përfundimit të studimeve për Drejtësi e deri në momentin e dërgimit të kësaj letre; Konkretisht: a. Punësimi im pranë Zyrës së Avokatisë trigoni; b. Punësimi im pranë Fakultetit të Drejtësisë/ Universiteti Kombëtar i Athinës, si asistent Profesor I Profesorit udhëheqës z. Andrea Dimitropoulo, c. Punësimi im pranë Fakultetit të Drejtësisë/ Universiteti i Zyrihut, pranë Prof. Regina Kiener.

²⁴ Mjetet provuese të punësimit tim pranë zyrës së avokatit, {...}: -Vërtetim i lëshuar nga Zyra e Avokatisë Trigonis (nga vetë z. Trigoni) i datës 7.2.2017 dhe depozituar pranë jush ditën e aplikimit tim. - Email i dërguar pranë KLGJ-së nga ana e z. Trigoni, pas kërkesës suaj, drejtuar zyrës së tij për konfirmimin e këtij punësimi, aktiviteti dhe kohëzgjatjen e tij në këtë zyrë.- Konfirmimin nga zyra e avokatit , {...} për aktivitetet konkrete që janë kryer në këtë zyrë dhe llojin e pagesës. Ky konfirmim i punësimit tim pranë zyrës të avokatit {...} është bërë nga vetë avokati në pranë të Dhomës Kombëtare të Avokatisë në Athinë (Vula e autoritetit kompetente, Dhomës Kombëtare të Avokatisë Athinë, e shoqëruar me vulën apostile). Në këtë deklaratë, pasi sqaron llojin e punësimit tim pranë kësaj zyre, {...} konfirmon, me përgjegjësi të plotë, përpara autoritetit kompetent të Greqisë (Dhomës Kombëtare të Avokatisë Athinë) punësimin tim ligjor si Jurist pranë zyrës së tij.- Konfirmimin nga autoriteti kompetent i Republikës së Greqisë për ushtrimin e profesionit të avokatit, {...} nga viti 1974 deri në ditët e sotme. (Ky vërtetim mban vulën e Dhomës Kombëtare të Avokatisë Athinë dhe vulën apostile). - Deklaratat e të ardhurave të mia për këtë periudhë. Këto dokumente janë të përkthyer, noterizuara dhe mbajnë vulën apostile, sikurse ju kërkon në e-mailin tuaj të datës 17.1.2020. Në atë kohë, deklarimi bëhej me një libër trifletësh në tri ngjyra, por, për shkak të kalimit të një kohe kaq të gjatë, këtë libër original nuk e disponoj më.- Kodi i Avokatisë greke i përkthyer në nenet që i referohen detyrave të asistentit të avokatit në Greqi. Përkthyer dhe noterizuar nga një përkthyer i licensuar pranë Ministrisë të Drejtësisë.-Linku zyrtar i Fakultetit të Drejtësisë, ku shpjegohen,

denoncime rreth kandidaturës sime, ku ju si organ, me të drejtë vendosët të hetoni mbi këto denoncime²⁵. Pasi mblodhët informacionin nga organet shtetërore, ju u mblodhët përsëri në mbledhjen e datës 19.10.2020, në të cilën pati përsëri denoncime në media për konflikt interesi midis meje dhe një anëtare të organit të organit tuaj të nderuar. Ky denoncim solli dhe dorëheqjen e znj. Luli nga procedura e përzgjidhjes sime. Juridikisht, unë nuk shikoj asnjë konflikt interesi midis meje dhe znj. Luli, pasi bashkëshorti i saj ndodhet në fazën e hetimit nga ana e KPK-së dhe s'ka asnjë vendim rreth këtij subjekti të rivlerësimit. Megjithatë, për hir të një procesi të drejtë, e pranoj si logjikë juridike dorëheqjen dhe pranimin e kësaj dorëheqje nga Kryetarja e Këshillit, bazuar në nenin 75 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Parashtrova ngjarjet e ndodhura më sipër për t'ju vënë në duke që çdo denoncim ose lajm rreth të dhënave që lidhen më këtë kandidim janë tërësisht false dhe kryhen nga individë, të cilët dëshirojnë të krijojnë dhe të hedhin tym në sytë e publikut për figurën time. Sikurse keni konstatuar ju vetë, unë kurrë s'kam qenë anëtar i ndonjë partie politike. Gjithmonë kam thënë të vërtetën rreth punësimeve të mia, sikurse ishte dhe rasti i kandidimit në pozicionin e anëtarit të KLGJ-së në vitin 2017. Ju keni verifikuar nëpërmjet korrespondencës me institucione të tjera shtetërore, që çdo document i dorëzuar pranë jush nga ana ime është i vërtetë. Duhet të kuptoni që përmbushja e detyrimeve të mia kushtetuese në rolin e Komisionerit Publik dhe vendimmarrja ime direkte në kryerjen e ankimeve ka krijuar shumë pakënaqësi në individë të ndryshëm, të cilët më sulmojnë vazhdimisht ditët që zhvillohen mbledhjet tuaja plenare, ku në rend të ditës është diskutimi për kualifikimin tim ligjor në pozicionin e anëtarit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kam besim të plotë që ju, si anëtarë të nderuar të këtij organi, e keni kuptuar tashmë këtë lojë të tyre dhe do të arrini të merrni një vendim final në mbledhjen e radhës. Tashmë, nga dokumentet që ju posedoni, të cilat pas kërkesave tuaja janë konform ligjit (vulat e institucioneve përkatëse dhe vulën apostile) duke marrë parasysh dhe kohën e gjatë që ka kaluar, ju do të keni arritur të krijoni një bindje bazuar gjithmonë në provat/dokumentet që përmban dosja ime e kandidimit.

Në këtë pikë më lejoni të sqaroj dhe disa momente, të cilat lidhen me mosnjohjet nga ana e organit tuaj të mbledhjeve plenare të fundit, të cilat kanë pasur në rend të ditës diskutimet për kandidaturën time. Në faqen nr. 1, në paragrafin e parë të materialit të dërguar nga ana juaj në datën 21.10.2020, ju citoni që: **Sikurse ju kemi bërë me dije më parë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Mbledhjen Plenare të datës 20.10.2020, ka vijuar me shqyrtimin e rezultateve të verifikimit lidhur me plotësimin nga ana juaj të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për emërim/ngritjen në detyrë si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 172, datë 11.9.2019. Unë nuk jam njoftuar për mbledhjen e datës**

analitikisht, studimet Bachelor për Drejtësi në Athinë. Në këtë link sqarohet dhe numri I provimeve të përmendura nga unë në këtë shkresë sqaruese. Ky link është përkthyer dhe noterizuar pranë një përkthyesi të licensuar pranë Ministrisë të Drejtësisë.

²⁵ 1.Nëse {...} ka kandiduar në zgjedhjet lokale të vitit 2011 me dy subjekte politike. 2. Për të marrë dosjen e kandidimit tim në organin KLGJ-së pranë Kuvendit të RSH-së. 3. Për të përkthyer Kodin e Avokatisë greke nga neni 1 deri në nenin 21.

28.9.2020 dhe mbledhjen e datës 19.10.2020. Kam marrë një njoftim nga ana juaj për zëvendësimin e relatorit tim të parë, z. Alban Toro, në datën 24.9.2020 dhe një email të dytë në datën 28.9.2020, për shtyrjen e mbledhjes së datës 28.9.2020, me qëllim për t'i dhënë kohën e nevojshme relatorit zëvendësues për të përgatitur një relacion shtesë me shkrim në lidhje me deokumentacionin e administruar rishtazi gjatë procedurës së verifikimit, si dhe për të marrë, në kuadër të kësaj procedure, informacione dhe dokumente nga disa subjekte publike. Gjithashtu, kam marrë një email nga ana e relatorit të ri, z. Toska në datën 21.10.2020, në të cilin më kërkohet të jap shpjegime në lidhje me dy gjetjet tuaja. Nga përmbajtja e kësaj shkrese nuk arrij të kuptoj kur është zhvilluar kjo mbledhje e fundit, pasi i vetmi informacion zyrtar që unë kam është ai i mediave. Në faqen e parë dhe paragrafin e parë të materialit tuaj citohet data 20.10.2020, ndërkohë në brendësi të materialit citohet data 19.10.2020. Mund të kuptoj që është bërë pas asnjë qëllim, por mbetet për t'u parë nga ju si organ pse unë si kandidat për pozicionin e anëtarit të Gjykatës së Lartë nuk njoftohem dhe çdo gjë e mësoj nga ana e mediave. Për këtë arsye, do t'ju lutesha të më informoni paraprakisht për mbledhjen plenare të radhës, në të cilën do të diskutohet në rend dite diskutimi për kualifikimin ligjor të kandidaturës sime”.

IV. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT

33. Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.

34. Po ashtu, kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin për Statusin, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. 2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

35. Për kandidatin {...} u verifikua kushtii kandidimit/emërimit ai i “qenies jurist”.

35.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar (të njësuar me origjinalin) kopjen, në gjuhën angleze, të dokumentit “Diplomë” {...}, lëshuar nga Universiteti i Athinës, Greqi, sipas të cilit kandidati {...} është dhënë titulli “Jurist”. Po ashtu, kandidati ka depozituar një Dokument {...}, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave, sipas të cilit: *“Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.523, datë 01.08.2003 “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, Komisioni i ngritur me Urdhërin nr.388, datë 15.12.2004 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në mbledhjen e datës 11.02.2005, mbasi ka shqyrtuar dokumentet e {...}, “Njohjen e kopjes së diplomës me {...} me titullin “Jurist”, lëshuar nga Universiteti i Athinës, Greqi”.*

35.2 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar (të njësuar me origjinalin) edhe kopjen, në gjuhën angleze, të dokumentit “Diplomë e Studimeve Pasuniversitare” nr. 23, datë 29.11.2005, lëshuar nga Universiteti Kombëtar e Kapodistrian i Athinës, Greqi, sipas të cilit kandidati {...} është diplomuar për studime pasuniversitare, në Programin e Studimeve të Europës Juglindore. Po ashtu, kandidati ka depozituar edhe Dokumentin “Dëshmi për njohjen e diplomimit” Nr. Regjistri 1526, Datë 11.05.2009, lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave, sipas të cilit: *“Mbështetur në nenin 37 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.24, datë 03.09.2007 “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe të certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”, Komisioni i Njohjes, në mbledhjen e datës 11.05.2009, mbasi shqyrtoi dokumentet e {...}, vendosi: “Njohjen e Diplomës së Studimeve Pasuniversitare të {...} nga Universiteti Kombëtar e Kapodistrian i Athinës, Greqi, me program 1-vjeçar në Studime të Eurapos Juglindore, si Diplomë e Nivelit të Dytë”.*

35.3 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të *“qenies jurist”*, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

36. Për kandidatin {...} u verifikua kushti i kandidimit/emërimit ai i *“pasjes sëpërvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”.*

36.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, sipas të cilit kandidati ka përvojë profesionale si lektor i së drejtës dhe jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Konkretisht, në mënyrë kronologjike, përvoja profesionale e kandidatit sipas dokumentit “Librezë Pune” është si vijon: “Pedagog” në Universiteti European i Tiranës, për periudhën 01.10.2009 -31.08.2013; “Dekan i Fakultetit të Drejtësisë” në Universitetin Luarasi Tiranë, për periudhën 06.10.2014-06.10.2015; “Pedagog ” në Universiteti i Neë York Tirana, për periudhën 30.10.2015-29.03.2018;“Komisioner Publik” në Institucionin e Komisionerët Publikë, për periudhën 30.03.2018 pa datë mbyllje.

36.2 Gjatë verifikimit, referuar subjekteve ku kandidati figuronte të kishte qenë i punësuar sipas dokumentit “Librezë Pune” dhe punësime të tjera të cilat nuk paraqiten në Librezë, prej tyre u kërkua informacion për të dhënat e punësimit të kandidatit. Konkretisht:

me Shkresën nr. {...}, Universiteti European i Tiranës informon se kandidati “*ka kryer detyrën e pedagog me kohë të plotë pranë fakultetit të drejtësisë, për periudhën 01.10.2009 - 31.08.2013*”;

me Shkresën nr. {...}, Universiteti Luarasi, Tiranë informon se kandidati “*ka kryer detyrën e Dekanit e fakultetit të drejtësisë, për periudhën 06.10.2014-22.12.2015*”;

me Shkresën nr. {...}, Universiteti Neë York informon se kandidati “*ka kryer detyrën e pedagog me kohë të plotë për periudhën 30.10.2015-23.08.2018 dhe pedagog me kohë të pjesshme për periudhën 15.05.2018-01.08.2018*”;

me Shkresën nr. {...}, Instituti Kanadez i Teknologjisë informon se kandidati “*ka kryer detyrën e pedagog, për periudhën 10.11.2018-27.06.2019*”;

me Shkresën nr. {...}, Institucioni i Komisionerëve Publikë informon se kandidati “*ushtron detyrën e Komisionerit Publik që nga periudha 30.08.2018*”;

me Shkresën nr. {...}, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë informon se kandidati “*ka fituar titullin avokat dhe është mbajtës i licencës nr. 2935, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, për vitit 2006, për periudhën pas këtij viti subjekti në fjalë figuron në regjistrin e avokatëve pasiv të Republikës së Shqipërisë për shkak të papajtueshmërisë ligjore për ushtrimin e profesionit të avokatit, parashikuar sipas nenit 7 të ligjit 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka ushtruar funksione pranë administratës publike*”;

me Shkresën e Protokolluar duke iu referuar komunikimit në rrugë elektronike nr. {...}, Profesor {...}(Athinë) informon se kandidati “*pas përfundimit të studimeve të doktoratës ka asistuar si pedagog dhe supervisor pranë universitetit National and Kapodistrian në Athinë për periudhën 2005-2009*”;

me Shkresën e Protokolluar duke iu referuar komunikimit në rrugë elektronike nr. {...}, Universiteti i Zyrhut informon se kandidati “*për periudhën 2013-2015 në mbrojtje të titullit profesor ka dhënë kontributin e tij në mënyrë të shkëlqyer të kërkimit shkencorë*”;

me Shkresën e Protokolluar duke iu referuar komunikimit në rrugë elektronike nr. {...}, Avokat {...} informon se kandidati “*ka kryer detyrën e juristit pranë kësaj zyre avokatie, për periudhën 01.10.2003-30.11.2005*”;

36.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht:

me Shkresën nr. {...}, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se “*Për shtetasin {...} ... për efekt burim to ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. Komisionerët Publikë - Komisioner Publik*”. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar dhe një kopje-historiku i punësimit sipas ESIG027, kopje-ekstrakti historik i punonjësit, me të gjithë të dhënat shifrore të pagës, sigurimeve shoqërore e shëndetësore,

kontributet përkatëse dhe TAP për çdo muaj, vit dhe subjekt/institucion punëdhënës, në të cilin ka punuar dhe/ose punon kandidati. Në historikun e punësimit sipas ESIG027 pasqyrohet punësimi i kandidatit: - në UFO, për periudhën Tetor 2015- Janar 2016;- në “University of Neë York”, për periudhën Tetor 2015- Mars 2018, si dhe në të njëjtin institucion arsimor për periudhën Maj 2018- Gusht 2018; - në Kolegjin Universitar Luarasi, për periudhën Tetor 2014- Tetor 2015; - në European Education Initiative, për periudhën Dhjetor 2011 - Gusht 2013; - në C.I.T, për periudhën Nëntor 2017- Qershor 2018, si dhe në të njëjtin institucion për periudhën Nëntor 2018- Qershor 2019. Ndërsa në ekstraktin historik të punonjësit pasqyrohet se kandidati për periudhën Mars 2012 e në vijim është i regjistruar si administrator i Kompanisë “World Trading Service” sh.p.k dhe nuk ka detyrime ndaj organit tatimor;

me Shkresën nr. {...}, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon për të dhëna punësimi të kandidatit për periudhën 2012 e në vijim, referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi informatik i saj, që dispononte të dhëna për kontributet që mblidheshin dhe dërgoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Web Service, të dhëna këto që disponoheshin nga viti 2012 dhe në vijim. Sipas të dhënave të dërguara përmes kësaj shkrese, jepen të njëjta të dhëna punësimi të kandidatit sikundër ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si më lart;

me Shkresën nr. {...}, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, informon për të dhënat e punësimit të kandidatit për periudhën 2009 - 2012, si vijon: si i punësuar në U.E.T, për periudhat Tetor 2009 - Dhjetor 2012.

36.4 Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidati {...} del të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon: 10 vjet pedagog në Shqipëri, 3 vjet e 10 muaj asistent profesor në Universitetin Kombëtar të Athinës si dhe 2 vjet Jurist.

36.5 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të *“pasjes sëpërvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

36.5.1 Në arritjen e këtij konkluzioni Këshilli merr në konsideratë faktin sëshumatorja e të gjitha eksperiencave profesionale të kandidatit deri në momentin e kandidimit të tij, plotësojnë kushtin e *“pasjes sëpërvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*. Këshilli vlerëson se për efekt të llogaritjes së përvojës minimale profesionale nuk ka rëndësi përvoja tërësore e punës së kandidatit, por ajo specifike në profesionet e parashikuara nga Kushtetuta e ligji, të tilla si : avokat, profesor, lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose jurist i spikatur/jurist i lartë në fusha të tjera të së drejtës. Përvoja minimale profesionale, jo më pak se 15/vjet, mund t’i referohet vetëm njërit nga profesionet e

mesipërme, por mund të vijë edhe si shumatore e përvojës profesionale në disa nga kategoritë e profesioneve që parashikon Kushtetuta, në tërësi jo më pak se 15/vjet.

36.5.2 Në rastin konkret është lehtësisht e konstatueshme që përvoja specifike e {...} si pedagog, profesor/lektor i së drejtës dhe Komisioner Publik (jurist i nivelit të lartë në administratën publike) në total ka një kohëzgjatje prej 13 vjet e 10/muaj. Kjo përvojë profesionale fillon që prej dhjetorit 2005 deri në momentin e kandidimit të tij në shtator 2019. Nga ana tjetër, gjatë procedurës së verifikimit dhe pas komunikimit të gjetjeve nga ana e Këshillit, ka rezultuar se kandidati ka përvojë profesionale si “jurist” pranë Zyrës së Avokatisë {...} Athinë Greqi, që prej tetorit 2003 deri në nëntor 2005. Nga kjo përvojë profesionale Këshilli konsideroi vetëm atë që përkonte me periudhën pas diplomimit të kandidatit, pra nga dt. 13.12.2003 deri në dt.30.11.2005. Kjo periudhë në vlerësimin e Këshillit, referuar dokumenteve të paraqitura nga kandidati dhe shpjegimeve të tij lidhur me gjetjet e komunikuar, duhej të konsiderohej si përvojë profesionale “jurist i spikatur/i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës”.

36.5.3 Këshilli konsideron se për termin “*jurist i spikatur*” apo “*jurist i lartë në një ose disa fusha të tjera të së drejtës*” nuk ka një përkufizim dhe as një listë profesionesh të përcaktuar në mënyrë shteruese në Kushtetutë apo në Ligj. Ky term kërkon një interpretim të natyrës së punës konkrete të kryer dhe vlerësimit të saj rast pas rasti. Në këtë kuptim, në këtë kategori përfshihen të gjithë ata juristë që janë angazhuar në çështje të ligjit dhe të së drejtës, veprimtaria profesionale të cilëve është e vlerësuar, pavarësisht se ajo nuk përkufizohet si avokat, profesor, lektor, apo jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Rëndësi të veçantë merr përshkrimi i punës së juristit, rezultatet e saj si dhe vlerësimi mbi to. Në mbështetje të këtij interpretimi, Këshilli konsideron edhe qëllimin e kushtetutbërësit mbi pluralitetin e përvojave të mëparshme të punës të kandidatëve që aplikojnë për gjyqtar të Gjykatës së Lartë, veprimtarinë e spikatur në tyre në fusha të ndryshme të së drejtës publike dhe asaj private, të cilat sigurojnë prurje të vlerave të posaçme dhe të gjithanshme profesionale, si dhe mundësi të barabarta midis juristëve, pavarësisht se veprimtaria e tyre profesionale nuk është ushtruar si avokat, pedagog, lektor i së drejtës apo jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Kushtetuta nuk ka pasur si qëllim që në Gjykatën e Lartë të lejohen të kandidojnë në kategorinë “jurist i spikatur” vetëm avokatët, profesorët e lektorët apo juristët e nivelit të lartë në administratën publike, por edhe ata juristë që në veprimtarinë e tyre në sektorin privat kanë shfaqur njohje shumë të mire të ligjeve, për të cilët aftësia, kontributi dhe rezultatet e punës janë vlerësuar maksimalisht.

36.5.4 Referuar përshkrimit të punës në vërtetimin e lëshuar nga Avokati {...}, me rastin e punësimit të {...} pranë kesaj Zyre Avokatore, rezulton se natyra e punës së tij, ka qenë e ndarë në 2 kategori:

ISHërbime profesionale të konsulencës dhe jo vetëm, në lidhje me çështjet e meposhtme :

- *Ndihmë në trajtimin gjyqësor dhe jashtëgjyqësor të çështjeve juridike;*
- *Ofrim këshillimesh juridike për persona fizikë dhe ligjorë;*
- *Kryerje kërkimesh në legjislacione të vendeve të ndryshme të BE-së të vendimeve gjyqësore dhe përgatitja e fashikujve gjyqësor për mbrojtjen e çështjeve nëpër gjykata;*

- *Hartim draftesh të padive në Gjykatat Civile dhe ato Administrative, drafte për kontrata civile dhe tregtare, si dhe dokumente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me shtetin grek dhe autoritetet administrative greke;*
- *Hartimi i legjislacioneve ndërkombëtare në nivel krahasues;*
- *Pjesëmarrje në takime ndërkombëtare dhe kombëtare;*
- *Përgatitje e amicus curiae në raste specifike, të cilat lidheshin drejtpërdrejtë me legjislacionin shqiptar dhe atë grek;*
- *Asistim në zhvillimin dhe implementimin e projekteve juridike që kishte kjo zyrë me ente të ndryshme publike dhe private.*

II Shërbime të përfaqësimit gjyqësor:

- *Përfaqësim me autorizim nga avokati si asistent avokat ose me autorizim nga të përfaqësuarit e Zyrës së tij në Gjykatat e Krimeve të lehta dhe në Gjykatat e Pajtitimit, si edhe pranë Autoriteteve Administrative dhe Shërbimeve Publike, për të kryer çështjet e Zyrës të Avokatisë.*
- *Bashkëpërfaqësim me avokatin, {...}, në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Dytë, për gjyqe të ndryshme, duke ushtruar praktikisht shërbimet e asistent avokatit, është pse “de jure” nuk e kishte këtë titull.*

36.5.5 Kjo përvojë profesionale si jurist është vlerësuar maksimalisht nga Avokati {...}. Ai ka vlerësuar {...} për kryerjen e detyrave të tij me zell, metodikë dhe efektshmeri të lartë. Ai e ka vlerësuar {...} jo vetëm për shkallën e lartë të integritetit, dinjitetit dhe ndërgjegjes profesionale, por edhe për përgatitjen e lartë profesionale dhe atë shkencore.

36.5.6 Përvoja e mësipërme e punës së {...} pranë Zyrës së Avokatisë {...} në Greqi, për periudhën 13.12.2003 deri në dt. 30.11.2005, në vlerësimin e Këshillit përbën përvojë profesionale si “jurist i spikatur në fusha të tjera të së drejtës”. Kjo periudhë bashkë me atë prej 13 vjet e 10/muaj si pedagog, profesor/lektor i së drejtës dhe Komisioner Publik (jurist i nivelit të lartë në administratën publike), tejkalojnë atë minimale profesionale prej 15/vjet të kërkuar nga neni 136 pika 3 e Kushtetutës.

37. Për kandidatin {...} u verifikua kushti i kandidimit/emërimit ai i “*pasjes gradë shkencore në drejtësi*”.

37.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Diplomë Doktorate”, lëshuar më datë 21.06.2011, nga Universiteti “National and Kapodistrian University of Athens, sipas të cilit “{...} fiton Gradë Shkencore “Doktor” në “Shkenca Juridike”.

37.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila, me Shkresën nr. {...}, informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se: “...*Grada shkencore “Doktor” në “Shkenca Juridike” e fituar nga {...} më datë 21.06.2011 në Universitetin “National and Kapodistrian University of Athens”rezulton të jetë njohur në*

Republikën e Shqipërisë bazuar në Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë nr.411, datë 24.04.2013 dhe figuron e regjistruar në regjistrin për Gradën Shkencore dhe titujt akademikë të mbrojtur jashtë vendit me nr. rendor 157.

37.3 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të *“pasjes gradë shkencore në drejtësi”*, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

38. Për kandidatin {...} u verifikua kushti i kandidimit/emërimit ai i *“mosmbajtjes së funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”*.

38.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 26.09.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*.

38.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u morën dhe vlejën të dhënat e informacioneve sipas pikës 36, të këtij vendimi.

38.3 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të *“mosmbajtjes së funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”*, përcaktuar në pikën 4, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në shkronjën “b”, pika 2, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

39. Për kandidatin {...} u verifikua kushti i kandidimit/emërimit ai i *“mosmbajtjes së pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”*.

39.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 26.09.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*.

39.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi, u kërkua dhe u mor informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me Shkresën nr. {...}, sa i përket kandidatit {...}, ka informuar se *“nuk rezulton të ketë qenë pjesë e organeve drejtuese të partive politike”*.

39.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u kërkuan dhe morën të dhëna nga dy parti politike, në funksion të denoncimit të bërë publik dhe të mbërritur edhe në adresën e Këshillit. Konkretisht:

me Shkresën nr. {...}, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4723/3, datë 01.10.2020, Partia Socialiste e Shqipërisë informon se: *“... {...} nuk figuron në database-in e partisë si anëtar*

dhe as si i zgjedhur në organet drejtuese vendore e qendrore të Partisë Socialiste për periudhën 26.09.2009-26.09.2019”;

me Shkresën e datës 06.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, Partia “Ligj dhe Drejtësi” informon se: “... {...} nuk ka qenë ndonjëherë anëtar i partisë “Ligj dhe Drejtësi”, nuk ka konkuruar ndonjëherë dhe nuk ka qenë i zgjedhur në pozicione drejtuese të partisë “Ligj dhe Drejtësi” dhe nuk ka marrë pjesë asnjëherë në garat elektorale për zgjedhjet politike apo në zgjedhjet vendor në Republikën e Shqipërisë”.

39.4 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të “mosmbajtjes së pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në pikën 4, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në shkronjën “b”, pika 2, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

V. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT

A. Për kriteret sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin

40. Disa nga kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Ligjin për Statusin, neni 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

40.1 Në nenin 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të nenit 28, të këtij ligji; ...”.

40.2 Ndërsa në nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit për Statusin, që parashikon kriteret e pranimit në formimin fillestar dhe bën pjesë në institutin e rekrutimit të kandidatëve magjistratë, përcaktohet se: “Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; ...; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; ...; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

41. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri kandidimit/emërimit ai i “pasjes së zotësisë së plotë për të vepruar”.

41.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi u mbajt në konsideratë se “zotësia për të vepruar”, si kategori juridike që i takon individit, gjen rregullim në legjislacionin civil (Kodin Civil), ndërsa i njëjti kuptim për të konsiderohet edhe kur individit është subjekt i të drejtës publike. Zotësia për

të vepruar nënkupton aftësinë e personit për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18 vjeç dhe, sipas ligjit, pasja e kësaj zotësie prezumohet deri në vërtetimin e heqjes apo kufizimit të saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

41.2 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidatit, ai del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Me Shkresën nr. {...}, gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informon se nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa me Shkresën nr. {...}, Dhoma Kombëtare e Noterisë, informon se nga verifikimi i bërë i listës së personave të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar, rezultoi se kandidati {...} nuk figuron në atë listë. Përtej kësaj, nga të dhënat e punësimit të kandidatit del që ai së fundmi ka qenë në marrëdhënie pune, në profesionin e pedagogut, çka indirekt nënkupton pasjen nga ai të zotësisë së plotë për të vepruar, përderisa kjo e fundit është një nga elementet e aftësisë për të kontraktuar në një marrëdhënie juridike pune, element ky i verifikueshëm në vijimësi në kuadër të ekzistencës së kësaj marrëdhënie.

41.3 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidatit, ai del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

41.4 Nga sa rezultoi nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kriterin e kandidimit/emërimit atë të *“pasjes së zotësisë së plotë për të vepruar”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “a”, të nenit 28, të Ligjit për Statusin.

42. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri kandidimit/emërimit ai i *“pasjes së shtetësisë shqiptare”*.

42.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “pasaportë”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 12.05.2011, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht *“shqiptare”*.

42.2 Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga Certifikata Elektronike Personale printuar në letër më datë 04.11.2019, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë *shqiptare*.

42.3 Nga sa rezultoi nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kriterin e kandidimit/emërimit atë të *“pasjes së shtetësisë shqiptare”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “b”, të nenit 28, të Ligjit për Statusin.

43. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri kandidimit/emërimit ai i *“mosqenies i dënuar me vendim penal të formës së prerë”*.

43.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr. {...}, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidati figuron *i padënuar penalisht*.

43.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), e cila, me Shkresën nr. {...} ndër të tjera, informon se nga verifikimi i bërë në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidati rezulton *i padënuar nga gjykatat penale shqiptare*.

43.3 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kriterin e kandidimit/emërimit atë të *“mosqenies i dënuar me vendim penal të formës së prerë”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “d”, të nenit 28, të Ligjit për Statusin.

44. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri kandidimit/emërimit ai i *“mosqenies i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe mospasjes masë disiplinore në fuqi”*.

44.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 26.09.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se *“gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore”*.

44.2 Po ashtu, në rastin e aplikimit, siç u përmend edhe më lart, kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, nga verifikimi i të cilës, në rubrikën “Shkaku i largimit nga puna”, nuk pasqyrohet në asnjë rast që kandidati të jetë larguar nga puna për shkaqe disiplinore.

44.3 Gjithashtu, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një Vërtetim nr. {...}, lëshuar nga Komisionerët Publikë” (punëdhënësi aktual), përmes të cilit vërtetohet se kandidati punon si Komisioner Publik prej marsit 2018 dhe se *“Që nga koha kur ka filluar punë ndaj {...} nuk është marrë ndonjë masë disiplinore dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi”*.

44.4 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga të gjithë subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidati ka punuar dhe punon aktualisht. Këto subjekte dhe informacione të përcjella nga ata evidentohen në paragrafin b.2, shkronja “b”, pika 35, të këtij vendimi. Konkretisht:

me Shkresën nr. {...}, Universiteti European i Tiranës informon se kandidati *“gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore”*;

me Shkresën nr. {...}, Universiteti Luarasi, Tiranë informon se kandidati *“gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore”*;

me Shkresën nr. {...}, Universiteti Neë York informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore*”;

me Shkresën nr. {...}, Instituti Kanadez i Teknologjisë informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore*”;

me Shkresën nr. {...}, Institucioni i Komisionerëve Publikë informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore*”;

me Shkresën nr. {...}, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë informon se kandidati “*nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces ndërkohë që për shkak se nuk ka zhvilluar aktivitet profesional të avokatit*”;

me Shkresën e Protokolluar duke iu referuar komunikimit në rrugë elektronike nr. {...}, Profesor {...} (Athinë) informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës rezulton të ketë qenë profesionalisht shumë mirë dhe ndaj tij nuk ka masa disiplinore*”;

me Shkresën e Protokolluar duke iu referuar komunikimit në rrugë elektronike nr. {...}, Universiteti i Zyrhut informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës rezulton të ketë qenë profesionalisht shumë mirë dhe ndaj tij nuk ka masa disiplinore*”;

me Shkresën e Protokolluar duke iu referuar komunikimit në rrugë elektronike nr. {...}, Avokat Aristeidis M.Trigonis (Athinë) informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës së juristit pranë kësaj zyre avokatie rezulton të ketë qenë profesionalisht shumë mirë dhe ndaj tij nuk ka masa disiplinore*”.

44.5 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kriterin e kandidimit/emërimit atë të “*mosqenies i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe mospasjes masë disiplinore në fuqi*”, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “dh”, të nenit 28, të Ligjit për Statusin.

45. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri kandidimit/emërimit ai i “*mosqenies anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*”.

45.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 26.09.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*”.

45.2 Gjatë verifikimit, në kushtet kur kandidati {...} është i vitlindjes {...}, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019, atij nuk iu kërkua plotësimi dhe dorëzimi i formularit të aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, përsa kohë referuar vitlindjes së kandidatit ai nuk mund të ketë qenë *anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*.

45.3 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kriterin e kandidimit/emërimit atë të *“mosqenies anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “ë”, të nenit 28, të Ligjit për Statusin.

46. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri kandidimit/emërimit ai i *“mosqenies bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”*.

46.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 26.09.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se *“nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”*.

46.2 Gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit edhe të kriterit të figurës së kandidatit, u kërkua dhe u mor informacion nga organet ligjzbatuese, nga të cilat nuk u bë prezent ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

46.3 Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli vlerëson se kandidati {...} plotëson kriterin e kandidimit/emërimit atë të *“mosqenies bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”*, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 49 në lidhje me shkronjën “f”, të nenit 28, të Ligjit për Statusin.

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit për Statusin

47. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49²⁶ në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32²⁷, të Ligjit të Statusit.

²⁶“5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

²⁷“2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshem të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5.

48. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. {...}.

48.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

48.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

49. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

49.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. {...}, ku për kandidatin {...}, krahas të dhënave në lidhje me punësimin të parashtruara më lart, referohet se për periudhën Mars 2012 e në vijim është i regjistruar si administrator i kompanisë {...}sh.p.k me NIPT {...} dhe nuk ka detyrime ndaj organit tatimor.

49.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. {...}, ku për kandidatin {...} në sistemin elektronik dhe administrimin e të dhënave ({...}) për periudhën mars 2004 e në vazhdim rezulton që kandidati të ketë kryer një procedurë doganore importi. Gjithashtu nga verifikimet e Drejtorisë Antitrafik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave nuk rezulton që kandidati të ketë deklarime me karakter pasuror.

50. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të

..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë. Të dhënat e referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rezultojnë të jenë deklaruar nga ana e kandidatit, si dhe të kenë qenë pjesë e kontrollit të plotë, nga ILDKPKI-ja, të pasurisë, asetëve dhe interesave të deklaruara nga kandidati.

51. Nga të dhënat e përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, por edhe nga ato të përftuara nga korrespondenca e saj me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion ky që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe nga analiza financiare e bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, konstatohet se Raporti është i plotë, i detajuar dhe i qartë, duke mos paraqitur ndonjë mangësi.

52. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit, Këshilli vlerëson se për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për atë nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket këtij kriteri. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'iu deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit për Statusin

53. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

54. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

55. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitet të kundërligjshme.

56. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 10.10.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

57. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. {...}, Vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin {...}”, sipas të cilit është vlerësuar se *“Subjekti deklarues {...}, kandidat për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

58. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. {...}, ka dërguar në Këshill një informacion me të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile. Sipas informacionit të dërguar, kandidati ka pasqyrim gabim të përbërësve të gjendjes civile, konkretisht vendlindja është pasqyruar gabim, nga “{...}” në “{...}”.

59. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. Për pasojë, u vlerësua që kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. {...}.

60. Në përgjigje të kërkesës së Këshillit për verifikim shtesë, Prokuroria e Përgjithshme, me Shkresën nr. {...}, informon Këshillin se pas kryerjes se verifikimeve konstaton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile dhe se nuk ka pasaktësi në deklaram të Formularit të Vetëdeklarimit nga ana e subjekti {...}. Në përgjigjen e saj, Prokuroria e Përgjithshme konkretisht ka parashtruar se: *“... Për të arritur tek vendimmarrja e datës 22.11.2019²⁸, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikime të plota dhe të thelluara, duke administruar përgjigjet zyrtare nga institucione të ndryshme, përfshirë këtu edhe përgjigjen zyrtare Nr. {...} të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. kjo e fundit na ka informuar zyrtarisht se subjekti {...}, me emrin e babait {...} dhe nënës {...}, lindur në Tiranë në datë {...}, i cili figuron banor i Njësisë Administrative Nr. {...}, Bashkia Tiranë, nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.*

²⁸Vendimi “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin {...}”.

Sipas aktit të lindjes Nr. {...} të administruar nga zyra e arkivës së gjendjes civile, në degën e qarkut Tiranë, për shtetasin në fjalë, rezultoi se përbërësi i gjendjes civile, rubrika e vendlindjes “Kamëz, Tiranë”. / Ligji Nr.138/2015, ka si qëllim të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve shtetërore, nëpërmjet pengimit të emërimit në to të personave të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve. Mosdeklarimi i ndryshimeve zyrtare të gjeneraliteteve nga subjekti deklarues me synim pengimin dhe fshehjen e dënimeve, konsiderohet shkelje e ligjit. / Subjekti {...} në Formularin e Vetëdeklarimit ka deklaruar me korrektësi çdo të dhënë sipas pyetjeve të formularit. Deklarimi nga ana e tij e vendlindjes, “{...}”, dhe jo “{...},{...}”, nga ana jonë është vlerësuar se nuk përbën deklaram të pasaktë, për disa arsye si më poshtë: - Ky deklaram nuk ka penguar Prokurorinë e Përgjithshme të kryejë një verifikim të thelluar administrativ të deklarameve të tij në Formularin e Vetëdeklarimit; - Nga verifikimet e kryera është konstatuar se ky deklaram i subjektit nuk është bërë për të fshehur ndonjë të dhënë kriminale, sepse nuk është konstatuar asnjë e tillë; - Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në shkresën drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranon faktin se nga punonjësit e saj vendlindja e subjektit është pasqyruar gabim nga “Kamëz”, në “Tiranë”, gjatë transkriptimeve në regjistra të ndryshëm ndër vite, pra nuk është subjekti që ka kërkuar ndryshimin e vendlindjes dhe as ka patur dijeni për këtë ndryshim të ardhur si rezultat i gabimeve materiale ndër vite, të punonjësve të Gjendjes Civile”. Mbi sa më lart, përmes përgjigjes së saj, Prokuroria e Përgjithshme ka konfirmuar se: “... i qëndron vendimmarrjes së datës 22.11.2019, në lidhje me subjektin {...}, vendimmarrje që është përcjell me shkresën nr. {...}”.

61. Nga formulari i vetëdeklarimit të kandidatit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ashtu edhe nga Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, nuk del që kandidati: të ketë qenë ndonjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj; të jetë dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë; të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një veprë penale; të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale; të ketë qenë ndonjëherë nën ndonjë masë shtrënguese sigurimi personal; të ketë qenë ndonjëherë në kërkim në bazë të ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale; të jetë dëbuar nga një shtet i huaj.

62. Nga verifikimi i kriterit të figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit, Këshilli vlerëson se për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për atë nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket këtij kriteri. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;

- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin mbi të cilën të ngrihen dyshime për papranueshmërinë e kandidimit të tij për gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

VI. KONKLUZIONE

63. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

64. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136, pikat 3 e 4 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pikat, 1, 2 dhe 5 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe në nenet 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “e”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. {...}, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Kryetare

NAUREDA LLAGAMI
(*kundër*)

Zëvendëskryetar

MAKSIM QOKU

Anëtar

MEDI BICI

Anëtare

BRIKENA UKPERAJ (LUBONJA)
(*kundër*)

Anëtare

BRUNILDA KADI

Anëtar

ILIR TOSKA

Anëtare

MARÇELA SHEHU
(*kundër*)

Anëtar

ERJON MUHARREMAJ
(*kundër*)

Anëtar

DRITAN HALLUNAJ

MENDIM PAKICE

Ne anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Naureda Llagami, Marçela Shehu, Erjon Muharremaj dhe Ilir Toska, shprehim qëndrimin tonë të ndryshëm nga shumica për rastin e Vendimit nr.560, datë 13.11.2020, dhënë për kandidatin për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, {...}.

Me Vendimin nr.560, datë 13.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shumicë votash, vendosi: *“Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. {...}, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

Ne anëtarët në pakicë votuam kundër kualifikimit të kandidatit {...}, pasi në vlerësimin tonë kandidati nuk plotëson kushtin e kandidimit të përvojës profesionale minimale, pikërisht atë të *pasjes jo më pak se 15 vjet përvojë si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës*, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

Konkretisht, në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: *“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi”.*

Kurse, në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”.*

Në rastin e kandidatit {...}, nga të dhënat e grumbulluara gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit, sa i përket përvojave profesionale të punës në përgjithësi deri në momentin e kandidimit më datë 26.09.2019, kanë rezultuar këto të dhëna:

- a) 1 Tetor 2003 - 30 Nëntor 2005 - *Jurist, Legal Officer/Zyrtar Ligjor* në Zyrën e Avokatisë së Aristeidis M.Trigonis, Athinë, Greqi - gjithsej 26 muaj;
- b) Dhjetor 2005 - Shtator 2009 - *Asistent pedagog* në Universitetin Kombëtar Kapodistrian të Athinës, Greqi - gjithsej 46 muaj;
- c) 1 Tetor 2009 - 31 Gusht 2013 - *Pedagog* në Universitetin European të Tiranës - gjithsej 47 muaj;
- ç) 16 Shtator 2013 - 15 Shtator 2014 - *Kërkues Shkencor* në Universitetin e Zyrihut, Zvicër - gjithsej 12 muaj;
- d) 6 Tetor 2014 - 30 Tetor 2015 - *Pedagog, Dekan* në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Luarasi - gjithsej 13 muaj;
- dh) 30 Tetor 2015 - 29 Mars 2018 - *Pedagog* në Universitetin New York të Tiranës - gjithsej 29 muaj;
- e) 30 Mars 2018 - 26 Shtator 2019 - *Komisioner Publik* në Institucionin e Komisionerëve Publikë - gjithsej 18 muaj.

Pra, në total, për kandidatin verifikohet të ketë 191 muaj ose 15 vjet e 11 muaj përvoja profesionale pune në përgjithësi.

Referuar përvojave profesionale të punës së kandidatit, rezulton se njëra prej tyre, pikërisht ajo për periudhën 26 mujore (1 Tetor 2003 - 30 Nëntor 2005), si *Jurist, Legal Officer/Zyrtar Ligjor* në Zyrën e Avokatisë së {...}, Athinë, Greqi, nuk përfshihet në asnjë prej përvojave specifike profesionale të përcaktuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kjo përvojë profesionale e kandidatit si jurist në një zyrë avokatie, nuk klasifikohet përvojë profesionale si “avokat” dhe as si “asistent avokat”, referuar për këtë legjislacionit grek për avokatinë, Ligjit nr. 4194, “Kodi i Avokatisë”, çka pranohet edhe nga shumica, por edhe nga vetë kandidati në rastin e shpjegimeve të paraqitura mbi gjetjen e procedurës së verifikimit.

Nisur nga kjo, rezulton që kandidati të ketë në total 13 vjet e 9 muaj përvoja profesionale pune nga ato të përcaktuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pra si *lektor i së drejtës dhe jurist i nivelit të lartë në administratën publike*. Për rrjedhojë, kandidati nuk plotëson përvojën profesionale minimale të kërkuar, duke patur kështu 15 muaj më pak.

Pikërisht nisur nga sa ka rezultuar mbi përvojën profesionale të punës së kandidatit, ne anëtarët në pakicë votuam kundër kualifikimit të tij dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. {...}.

Shumica, në vendimin e saj, ka pranuar se përvoja profesionale e punës së kandidatit *si Jurist, Legal Officer/Zyrtar Ligjornë Zyrën e Avokatisë së {...}*, Athinë, Greqi, përbën përvojë profesionale si *“jurist i spikatur në fusha të tjera të së drejtës”*, referuar vlerësimin për punën e kandidatit nga Avokati {...}.

Ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se puna/shërbimi në një zyrë avokatie nuk mund të konsiderohet si përvojë profesionale në një fushë tjetër të së drejtës në kuptim të pikës 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të pikës 1, të nenit 49, të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kushtetutbërësi dhe ligjvënësi në këto dispozita ka përcaktuar fushat kryesore të përvojave profesionale të punës dhe, për përtej tyre, për sa nuk përfshihen në to, ka përcaktuar në mënyrë të përgjithshme edhe përvojën si *“jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*.

Duke ardhur në rastin konkret, përvoja profesionale e kandidatit si jurist në një zyrë avokatie, për ne anëtarët në pakicë, kurrsesi nuk mund të klasifikohet përvojë profesionale si *“jurist i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës”*. Është e qartë se fusha e përvojës profesionale të kandidatit në këtë rast është ajo e avokatisë, fushë për të cilën Kushtetutbërësi dhe ligjvënësi kanë konsideruar si të vlefshme vetëm përvojën profesionale si “avokat” dhe asnjë lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me këtë fushë. Shumica nuk specifikon fushën e së drejtës, për të cilën kandidatit i njeh përvojën si jurist i nivelit të lartë, sikundër po ashtu nuk arsyeton se përse në hierarkinë e një zyre avokatie, pozicioni i juristit klasifikohet si i nivelit të lartë.

Për sa më lart, ne anëtarët në pakicë u shprehëm kundër për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin për të të procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. {...}, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kryetare

Anëtare

Anëtar

Anëtar

NAUREDA LLAGAMI MARÇELA SHEHU ERJON MUHARREMAJ ILIR TOSKA